VENDIM
Nr. 59, datë 16.9.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha,	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha,	anëtar i	"	"
Gani Dizdari,	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vladimir Kristo,	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 33 Akti, që i përket:

KËRKUES: Luan Pashollari

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2015-965 (76), datë 12.2.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 21–27 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka qenë efektiv pranë strukturave së Policisë së Shtetit dhe ka kryer detyrën si komandant i Repartit të Policisë së Rendit deri në datën 16.12.2006, pasi me urdhrin nr. 2126/3, datë 30.11.2006 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit është larguar nga puna. Arsyetimi i këtij largimi ka qenë shkurtimi i funksionit organik, si dhe mungesa e arsimit përkatës.

2. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ta dëmshpërblejë me pagën e pesë vjetëve punë për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.

3. Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, me vendimin nr. 629, datë 16.7.2007, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë, të dëmshpërblejë kërkuesin Luan Pashollari me pagën e një viti e gjysmë pune për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit për rikthimin në punë si të pabazuar.

4. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 327, datë 22.10.2007,

me të njëjtin arsyetim.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 513, datë 15.11.2011, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 327, datë 22.10.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr. 629, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me tjetër trup gjykues. Sipas këtij vendimi i është lënë detyrë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec që si palë e paditur duhej thirrur edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 609–355, datë 23.4.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të dëmshpërblejë kërkuesin Luan Pashollari me pagën e dy vjetëve punë, në shumën prej 1.170.960 lekësh, për zgjidhjen e menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës apo të shërbimit, si dhe pushimin pjesërisht të gjykimit lidhur me palën e paditur, Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë.

7. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 638, datë 6.11.2012, ka vendosur, lënien në fuqi të vendimit nr. 355, datë 23.4.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Ky vendim është vënë në ekzekutim nga kërkuesi.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, mbi rekursin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me vendimin nr. 00-2015-965 (76), datë 12.2.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 609–355, datë 23.4.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe të vendimit nr. 638, datë 6.11.2012 të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

II

9. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata") për shfuqizimin e vendimit objekt kërkese, me pretendimin se:

9.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi nuk ka respektuar dispozitat që lidhen me njoftimin e palëve ndërgjyqëse për zhvillimin e gjykimit.

9.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit.

9.3 Rekursi pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është shqyrtuar tej afateve që parashikon neni 60/2 i ligjit nr. 49, datë 16.5.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (ligji nr. 49/2012).

10. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Policisë së Shtetit,*** ka paraqitur me shkrim këto prapësime:

10.1 Kërkuesi ka pasur dijeni për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, sepse sekretaria e Gjykatës së Lartë ka njoftuar me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, sipas parashikimit të nenit 61/2 të ligjit nr. 49/2012.

10.2 Afati ligjor 90-ditor që kërkuesi i referohet për cenim të procesit të rregullt ligjor, nuk mund të barasvlerësohet me afatin e arsyeshëm, pasi arsyeshmëria e afatit, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, duhet parë *lato sensu* dhe jo *stricto sensu.*

11. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë***, ka prapësuar me shkrim, si më poshtë vijon:

11.1 Kërkuesi është njoftuar për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë konform rregullave të caktuara në nenin 61/2 të ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet se njoftimi për palët bëhet me shpallje, sikurse ka ndodhur në rastin konkret.

11.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e çështjes nuk ka bërë vlerësim provash, por interpretimin e ligjit material, çka hyn në kompetencat e tij.

11.3 Shqyrtimi i rekursit tej afatit 90-ditor të parashikuar në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012, nuk

përbën shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

13. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi, *prima facie,* legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim

14. Kërkuesi pretendon se Kolegji Admini-strativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar dispozitat që lidhen me njoftimin e palëve ndërgjyqëse për zhvillimin e gjykimit, pasi nga ana e sekretarisë nuk është kryer asnjë njoftim sipas nenit 61/2 të ligjit nr. 49/2012.

15. Subjektet e interesuara, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, kanë prapësuar se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, sepse sekretaria e Gjykatës së Lartë ka njoftuar me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, konform parashikimit të nenit 61/2 të ligjit nr. 49/2012.

16. Gjykata vëren se me miratimin e ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos-marrëveshjeve administrative" është parashikuar, mes të tjerash, edhe procedura e gjykimit të këtyre çështjeve. Sipas nenit 59 të ligjit nr. 49/2012 pala kundër së cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces (neni 60). Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

17. Në rastin në shqyrtim, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të gjykimit, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, për të cilin kërkuesi ka marrë personalisht dijeni në datën 21.12.2012. Me vendimin e datës 22.1.2015, gjyqtari relator i çështjes ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 12.2.2015, duke urdhëruar sekretarinë të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 12.2.2015 rezulton se Kolegji Administrativ ka vlerësuar se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit dhe ka marrë në shqyrtim vetëm shkaqet e ngritura në rekurs, ndërkohë që nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur kundërrekurs ose parashtrime me shkrim ndaj pretendimeve të palës tjetër. Përfundimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-965 (76), datë 12.2.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 609–355, datë 23.4.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe të vendimit nr. 638, datë 6.11.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi ose jo i kritereve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, sipas ligjit nr. 49/2012. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata e

Lartë, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve admini-strative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se Gjykata e Lartë ka detyrimin jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Bazuar në standardet e lartpërmendura, Gjykata çmon se në rastin objekt shqyrtimi, edhe pse sekretaria gjyqësore i ka përmbushur kriteret e caktuara nga ligji për njoftimin e palëve me shpallje, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të parashtruara në rekurs, duke mos i dhënë mundësinë kërkuesit që të paraqiste pretendimet e tij në lidhje me çështjen. Në këtë mënyrë, edhe pse shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë pasi kishte kaluar një hark kohor prej pothuajse tre vjetësh nga dhënia e vendimit të formës së prerë nga ana e Gjykatës së Apelit Korçë, i cili ishte vënë në ekzekutim nga ana e kërkuesit, Kolegji Administrativ nuk ka marrë të gjitha masat për t'i garantuar atij të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim është i bazuar.

C. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

21. Kërkuesi pretendon se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit prej gjykatës ku ai është depozituar.

22. Drejtoria e Policisë së Shtetit ka prapësuar se afati ligjor 90-ditor që kërkuesi i referohet për cenimin e procesit të rregullt ligjor nuk mund të barasvlerësohet me afatin e arsyeshëm, pasi arsyeshmëria e afatit, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, duhet parë *lato sensu* dhe jo *stricto sensu,* ndërsa Drejtoria Vendore e Policisë Korçë prapëson se shqyrtimi i rekursit tej afatit 90 – ditor të parashikuar në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012, nuk përbën shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 14, datë 10.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (shih *vendimin nr. 45, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se duhet të merret në analizë secili prej elementeve të sipërcituara.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

25. Lidhur me periudhën e *kohës që duhet marrë në konsideratë,* nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.1.2013 dhe gjykimi është bërë në vitin 2015, ndonëse neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin prej 90 ditësh për shqyrtimin e çështjes nga kjo Gjykatë.

ii) Kompleksiteti i çështjes

26. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme *(shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Objekti i saj lidhet me vlerësimin e dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe të kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkuesit

28. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

29. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushte-tutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit: "*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme"*, dhe në nenin 171/a të KPC-së, sipas të cilit: "*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj"* (*shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka konstatuar se neni 3 i ligjit nr. 49/2012, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin bashkëlidhur projektligjit nr. 49/2012 thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve admini-strative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është mbrojtja efektive e të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata, gjithashtu, ka vërejtur se në relacionin e projektligjit të lartpërmendur lexohet se afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e

seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60/2 në shqyrtim).

31. Nga sa më lart, Gjykata ka çmuar se përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Po në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se justifikimi në çështje të ngjashme se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushte-tuese*).

33. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se prapësimi i Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë se shqyrtimi i rekursit tej afatit 90-ditor, të parashikuar në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012, nuk përbën shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe ai i Drejtorisë së Policisë së Shtetit se afati ligjor 90-ditor që kërkuesi i referohet për cenimin e procesit të rregullt ligjor nuk mund të barasvlerësohet me afatin e arsyeshëm, pasi arsyeshmëria e afatit, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, duhet parë *lato sensu* dhe jo *stricto sensu*, nuk janë të bazuara.

34. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, është i drejtë dhe si i tillë duhet pranuar.

Ç. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

35. Kërkuesi pretendon se Kolegji Admini-strativ i Gjykatës së Lartë ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

36. Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, për këtë pretendim ka prapësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e çështjes nuk ka bërë vlerësim provash, por interpretimin e ligjit material, çka hyn në kompetencat e tij.

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"*. Zbatimi i këtij parimi ka gjetur trajtim nga kjo Gjykatë edhe lidhur me funksionin rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se procesi konsiderohet i rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë themelin e çështjes për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në këto raste, kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Për këtë arsye, Gjykata është shprehur se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Bazuar në këto standarde, Gjykata është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e

kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 2, datë 26.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në rastin në shqyrtim, nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vëren se në arsyetimin e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, pasi ka vlerësuar se shkaqet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës janë të paarsyeshme, ka vendosur masën e dëmshpërblimit në shumën e pagës për dy vjet punë. Lidhur me përfitimin suplementar që ka përfituar kërkuesi, gjykata ka argumentuar se pagesa kalimtare është një përfitim që ligji ua njeh punonjësve të Policisë së Shtetit për shkak të kontributeve suplementare të tyre, i cili nuk ka lidhje me masën e dëmshpërblimit që kërkuesi ka të drejtë të kërkojë për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.

41. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 638, datë 6.11.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 355, datë 23.4.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhe në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim të kërkuesit ka arsyetuar se trajtimi i paditësit me pagesë kalimtare nuk ka lidhje me kërkimin e tij dhe nuk është shkak ligjor për të mos njohur dëmshpërblimin që vjen si pasojë e ndërprerjes në mënyrë të padrejtë të marrëdhënies së punës, pasi nëse këto marrëdhënie do të vazhdonin, paditësi do të kishte një situatë financiare shumë të favorshme.

42. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se interpretimi i gjykatave të faktit është i gabuar si për sa i përket së drejtës së kërkuesit për të përfituar shpërblim lidhur me lirimin e tij nga detyra e po kështu lidhur me masën e dëmshpërblimit të njohur nga gjykatat, masë e cila nuk është në përputhje me vendimin nr. 31/2003 të Kolegjeve të Bashkuara. Sipas Gjykatës së Lartë: *"qëllimi i ligjvënësit në dhënien e pagesës kalimtare është që të mbështesë përkohësisht, financiarisht, punonjësin e Policisë së Shtetit që lirohet apo largohet nga ky shërbim me kërkesën e tij apo me vendim të organeve eprore për shkaqe riorganizimi etj., të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e mëtejshëm të karrierës policore. "Ndërprerja" apo "pamundësia" e vazhdimit të karrierës policore përfshin të gjitha ato raste kur punonjësi i policisë nuk është përjashtuar nga Policia e Shtetit për shkelje të ligjit, disiplinore apo penale. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se në thelb përfitimi i pagës kalimtare kur punonjësi i Policisë së Shtetit ndërpret karrierën jo për shkaqe disiplinore nuk njehsohen me shpërblimin e dëmit që përfiton punonjësi i policisë nëse marrëdhënia e punës ndërpritet në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. Paditësi për shkak të daljes së tij në lirim përfiton pagesën kalimtare dhe në këtë drejtim nuk shtrohet për diskutim nëse kanë ekzistuar apo jo shkaqe të arsyeshme apo të justifikuara në kuptim të neneve 146 dhe 153 të K. Punës, pasi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mes të palëve gjejnë zbatim dispozitat e ligjit të posaçëm. Prandaj nuk ka arsye ligjore që punëdhënësi të ngarkohet me përgjegjësi për të dëmshpërblyer punëmarrësin në bazë të dispozitave të Kodit të Punës".*

43. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se përderisa ka konstatuar se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë jokushtetues, për shkak të cenimit të së drejtës së kërkuesit për të marrë pjesë në gjykim, Gjykata e Lartë në rigjykimin e çështjes duhet të mbajë parasysh standardet kushtetuese të

lartpërmendura edhe për respektimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj[1].

44. Si përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, kërkesa e shtetasit Luan Pashollari duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00–2015–965 (76), datë 12.2.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

[1] Gjyqtarët V. Kristo dhe G. Dizdari votuan për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka atribuuar vetes kompetenca të paautorizuara nga ligjvënësi, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 35, datë 27.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.